



**QYTETARI NË
REND TË PARË**



**UEB-FAQE NË VEND
TË SPORTEELIT**

**TË GJITHA INFORMACIONET
ME 3 KLIKIME**




Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian
dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike Shkup



ALKA





2

Bota në të cilën jetojmë është e rrethuar me teknologji. Qytetarët gjithnjë e më shumë i përdorin telefonat dhe kompjuterët për socializim, blerje në internet, komunikim, menaxhim të financave, caktim të kontrollit mjekësor, informim etj.

Në këtë kontekst, nuk duhet të na befasojë ajo që qytetarët presin ta marrin të njëjtin hap edhe vetëqeverisjet lokale. Ata duan të jenë të informuar, të dorëzojnë kërkesa dhe të jenë të shërbyer duke përdorur internetin.

Qytetarët presin nga autoritetet lokale të jenë të pranishëm edhe në rrjetet sociale dhe të njëjtit shpejt të përgjigjen në kërkesat e tyre dhe të jenë të përgjegjshëm dhe transparent për çështjet që i prekin ata.

Interneti është një mundësi e madhe për vetëqeverisjet lokale, dhe ju ofron një numër të madh të mjeteve për të rritur shkallën e transparencës dhe llogaridhënies, dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset. Teknologjia ju lejon autoriteteve lokale drejtpërdrejtë ti transmetojnë këshillat komunal, qytetarët të mund të komentojnë dhe të dorëzojnë propozime.

Megjithatë, kjo mundësi nuk përdoret mjaft nga vetëqeverisjet tona lokale - ueb-faqet janë shpesh të pakta në përmbajtje, kërkimi i informacioneve është i vështirë, faqet nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme për të përfshirë qytetarët apo për shërbimin e tyre elektronik.

Si duhet të duket ueb faqja e komunës



Figura 1 - Shembull: Ueb-faqja e Belfastit, Irlanda Veriore

Ueb-faqet e vetëqeverisjeve lokale duhet të ofrojnë navigacion të lehtë dhe të thjeshtë, duke respektuar rregullin në “tre klikime”, d.m.th. përdoruesi të mund të hyjë në çdo përmbajtje të dëshiruar me maksimum tre klikime.

Ky rregull në dukje është pak kompleks për tu realizuar, por mund të realizohet me planifikim të mirë në strukturën dhe përmbajtjen e ueb faqes.

Ueb-faqet e vetëqeverisjeve lokale në vendin tonë nuk janë të unifikuara, apo secila komunë ka metodën e vet të përgatitjes dhe prezantimit të informacionit që ajo ofron.

Qytetarët që vizitojnë ueb-faqet e vetëqeverisjeve të ndryshme lokale e kanë jashtëzakonisht vështirë të gjejnë informacione të njëjta në të dyja vendet. Prandaj, kemi nevojë të zbatohet iniciativë për një strukturë të unifikuar dhe dizajn të ueb-faqeve të të gjitha komunave.



Navigacioni në ueb faqe shpesh është konfuz pa një grupim mirë të planifikuar të kategorive, qasje në informacione nga fusha të ndryshme, apo informim të mënyrës së marrjes së shërbimeve publike nga vetëqeverisja lokale.

Nga ana tjetër, gama e informacioneve të ofruara për qytetarët nëpërmjet ueb faqeve është shumë e vogël. Shpesh, ueb-faqet bëhen vetëm për qëllime promovuese d.m.th. promovimin e aktiviteteve të realizuara nga komuna ose menaxhmenti i saj.

Si ti organizojnë vetëqeverisjet lokale ueb faqet e tyre


Gjëja e parë që duhet të ketë vëmendje është ueb-faqja qendrore (kryesore) e ueb-lokacionit ku përdoruesi fillimisht qaset.

Navigacioni kryesor duhet të jetë në vend prioritar, për shkak se vendosja e navigacionit në vend të pazakontë do të ngatërronte përdoruesin.

4

Menyja e navigacionit nuk duhet të përfshijë më shumë se shtatë kategori. Ky rregull në përpunimin e ueb faqeve është bazë e asaj, se memoria afatshkurtër e njeriut nuk ruan më shumë se shtatë elemente.

Faqja kryesore duhet ti përfshijë të rejat e fundit, si dhe përmbajtjet që janë më të rëndësishme për qytetarët dhe cilët ata më shumë i kërkojnë, siç është qasja në udhëzime dhe formularët për shërbimet më të përdorura nga vetëqeverisja lokale¹.



Të gjitha informacionet që ju ofrohen qytetarëve duhet të grupohen sipas fushës të cilës i përkasin, siç është: këshilli dhe administrata, financat, arsimit, kulturës, sportit, mjedisit jetësor, planifikimit urban etj. Këto fusha duhet të jenë lehtësisht të arritshme nga faqja kryesore.


Çdo fushë duhet të ofrojë informacione të saja të veçanta, por duhet të dominojë një dizajn i ngjashëm për të siguruar përvojë të standardizuar për përdoruesit.

¹ Llojet e informacioneve që rekomandohen të publikohen përfshihen në publikimin e Qendrës për menaxhim me ndryshime, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm – ALKA, Standardet në e-transparencën e vetëqeverisjeve lokale 2017

Shembull i strukturës së navigacionit në ueb faqe të vetëqeverisjes lokale

1. Për komunën

- ◆ Kryetar komune
- ◆ Këshilli
 - Rregullorja e punës së Këshillit
 - Mbledhjet e Këshillit
 - Komisionet dhe organet e Këshillit
 - Buletinët zyrtar
- ◆ Administrata
 - Bashkësitë lokale dhe urbane
 - Dokumente strategjike
 - Statuti



2. Financat

- ◆ Buxheti:
- ◆ Buxheti qytetar
- ◆ Shpenzimet komunale
- ◆ Prokurimet publike
- ◆ Llogaria përfundimtare

3. Projekte

4. Shërbime

5 . Informacione sipas fushave

- ◆ Arsim
 - Shkolla fillore
 - Shkolla të mesme
- ◆ Kopshte për fëmijë dhe shtëpi për pleq
 - kopshte për fëmijë
 - shtëpi pleqsh

- ◆ Kulturë
 - Objekte dhe institucione nga fusha e kulturës
 - Përmendore dhe pllaka përkujtimore
- ◆ Sport
 - Objekte sportive
 - klube sportive
- ◆ Mjedisi jetësor
 - Substanca ndotës në ajër
 - Ndotës të kategorisë B në territorin e komunës
 - Prodhimi i mbeturinave
 - Leje mjedisore të lëshuara B-të integruara
- ◆ Zhvillimi ekonomik lokal
 - Subjektet që ofrojnë shërbime hotelierike
 - Subjektet që ofrojnë shërbime turistike

- ♦ Veprimtari komunale
 - Transportuesit dhe automjete të regjistruara për transportin e udhëtarëve dhe mallrave në trafikun rrugor
- ♦ Kujdesi social
 - Institucionet për kujdes social të kategorive të ndryshme të qytetarëve
 - Ndihma financiare të njehershme
- ♦ Urbanizëm
 - I përgjithshme / Plani detal urbanistik
- transporti publik
- parkingje
- lejet e ndërtimit
- ♦ Organizata qytetare

6. Të dhëna të hapura

7. Kontakt

- ♦ Informacione të karakterit publik
- ♦ Kontakt personi për personat me aftësi të kufizuara

Mjete interaktive

6




Atje ku ka mundësi dhe kapacitete, ueb faqja duhet të ofrojë një shumëllojshmëri të mjeteve përmes të cilave do të mundësohet komunikim interaktiv ndërmjet qytetarëve dhe vetëqeverisjes lokale.

Për shembull, vetëqeverisja lokale mund të imponojë një seksion forum, ku qytetarët mund të debatojnë për çështje të ndryshme me interes për komunitetin, apo të raportojnë probleme të ndryshme me të cilat përballen.

Disa vetëqeverisje të avancuara lokale në botë ofrojnë mundësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me administratën e komunës, të tilla si mundësimi i mjeteve për “chat” komunikim.

Qasja në ueb



Qasja në ueb do të thotë përpunimi i ueb-faqeve duke eliminuar pengesat që e vështirësojnë qasjen dhe bashkëveprimin e personave me aftësi të kufizuara. Përgatitja e duhur e ueb faqeve mundëson qasje të barabartë për të gjithë përdoruesit.

Për shembull, vendosja e përshkrimit tekstual në fotografitë do tu mundësojë personave të verbër ta marrin informacionin në lidhje me foton, sepse ata përdorin softuer për sintezën e të folurit, pra për lexim kompjuterik të përmbajtjes së tekstit.

Një shembull tjetër është shmangia e efekteve ndriçuese në ueb faqe, për shkak se disa njerëz mund të përjetojnë sulme foto-epileptike nga efekte të tilla.

Të gjitha këto parime janë të përfshira në manualin për qasjen në ueb përmbajtjet WCAG 2.0, të publikuara nga Iniciativa për ueb-qasje (WAI) të konsorciumi W3C². Ky manual jep udhëzime të hollësishme se si të bëhen përmbajtjet të arritshme, kryesisht për persona me aftësi të kufizuara, por edhe për pajisje të tjera me të cilat tentohet të arrihet. Manuali përfshin 12 drejtime, të organizuara në 4 parime, dhe për secilën nga drejtimet janë përcaktuar kriteret.

Në mënyrë që të sigurojë qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara që përdorin teknologji ndihmëse për punë me kompjuterë dhe internet, rekomandohet të përmbushet niveli AA i këtij manuali.

² <https://www.w3.org/WAI/intro/wcag>



QENDRA PËR
MENAXHIM ME
NDRYSHIME

Qendra e menaxhimit me ndryshime

Rr. Rajko Zhinzifov nr. 44-1, Shkup
Tel.+389(0)2 6092-216
e-mail: info@cup.org.mk
ueb: www.cup.org.mk

ALKA

Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA

Bul. Partizanski odredi nr. 62-1/16, Shkup
Tel.: + 389(0)2 3214-505
e-mail: alka@alka.org.mk
ueb: www.alka.mk



Bashkimi Evropian

Ky publikim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Qendrës për menaxhim me ndryshime dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



British Embassy
Skopje

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Ambasada Britanike Shkup në kuadër të projektit - Qytetari në rend të parë. Pikëpamjet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë gjithmonë pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Projekti - Qytetari në rend të parë - është zbatuar nga Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve në partneritet me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm - Alka. Bashkëpunëtorë në këtë projekt janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Projekti është i financuar nga Delegacioni Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e kontraktave (CFCD) dhe i bashkë-financuar nga Ambasada Britanike.

Projekti fokusohet në përmirësimin e transparencës së njërive të vetëqeverisjeve lokale duke vendosur standarde për të dhëna të hapura në nivel lokal me qëllim të përfshirjes më të mirë të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e punës dhe vendimmarrjes nga ana e komunave.